



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 11

7 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 46, datë 29.1.2014	Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave	203
Vendim i KM nr. 47, datë 29.1.2014	Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit	206
Vendim i KM nr. 48, datë 29.1.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 541, datë 13.6.2013 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i landfillit “Bajkaj”	209
Vendim i KQZ nr. 5, datë 28.1.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Lezhë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	211
Vendim i KQZ nr. 6, datë 28.1.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	212

VENDIM
Nr. 46, datë 29.1.2014

**PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE DHE UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 51, pika 3 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE DHE UJËRAVE

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (në vijim “ISHMPU”), si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin.

2. Ministria përgjegjëse mbështet funksionimin efektiv të ISHMPU-së. Në këtë përgjegjësi nuk përfshihet drejtimi operacional i veprimtarisë së inspektimit.

II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHMPU-së

1. ISHMPU-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve dhe ujërave.

2. ISHMPU-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën përkatëse, në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, ujërat dhe pyjet.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij kreu, ISHMPU-ja është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e mjedisit.

4. ISHMPU-ja ushtron juridiksionin e vet territorial në të gjithë territorin e vendit.

III. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË ISHMPU-së

1. ISHMPU-ja organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal, ku këto të fundit janë për çdo rajon të vendit.

2. ISHMPU-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili është titullar i institucionit.

3. Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të ISHMPU-së, kryeinspektori ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson inspektoratin në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së këtij inspektorati;

b) i propozon ministrit emërimin dhe lirimin nga detyra të personelit të ISHMPU-së dhe të degëve rajonale, në varësi të tij, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi;

c) zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHMPU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës;

ç) nxjerr urdhra për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës për përcaktimin e procedurave, kompetencave, detyrave dhe funksioneve për kryerjen e veprimtarive inspektuese të strukturave të ISHMPU-së, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve dhe ujërave;

d) bashkërendon veprimtarinë e ISHMPU-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve dhe ujërave;

dh) siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve dhe ujërave, si dhe kryen veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin në këtë fushë;

e) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve dhe ujërave;



ë) ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

4. Kryeinspektori i ISHMPU-së i raporton drejtpërdrejt ministrit përgjegjës për mjedisin, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparat in e ministrisë përgjegjëse.

5. ISHMPU-ja në nivel qendror ka këto funksione:

- a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit;
- b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi;
- c) bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të vet dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e vet;
- ç) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;
- d) jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;
- dh) përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit.

6. Përveç sa parashikohet në pikën 5 të këtij kreu, ISHMPU-ja në nivel qendror është përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme për të gjithë institucionin, përfshirë edhe degët në nivel rajonal:

- a) menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe ndjekjen e çështjeve ligjore, të teknologjisë së informacionit, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera mbështetëse;
- b) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

7. Pranë ISHMPU-së në nivel qendror krijohet “Komisioni i ankimit të ISHMPU-së”, i cili drejtohet nga kryeinspektori.

8. Përbërja nominale e komisionit të ankimit, procedurat për shqyrtimin e ankimeve dhe mënyra e vendimmarrjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Komisioni i ankimit të ISHMPU-së ushtron funksionet në përputhje me afatet dhe procedurat e ankimeve të parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

10. Degët rajonale të ISHMPU-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në qarkun përkatës. Me urdhër të kryeinspektorit, inspektorët e një dege rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me degën rajonale përkatëse.

11. Degët rajonale, që kanë në territorin e tyre pika të kalimit të kufirit, bashkëpunojnë me organet doganore dhe organet e tjera përkatëse për parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të veçantë.

12. Degët rajonale të ISHMPU-së drejtohen nga drejtuesi i degës rajonale. Drejtuesi i degës rajonale përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

13. Përveç sa parashikohet në pikën 12 të këtij kreu, drejtuesi i degës rajonale:

- a) jep autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;
- b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, vendos për zëvendësimin e inspektorëve gjatë inspektimit, me përjashtim të rasteve kur urdhërohet nga kryeinspektori qendror.

14. Drejtuesi i degës rajonale i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejt kryeinspektorit të ISHMPU-së, përveçse kur kryeinspektori ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë ISHMPU-së në nivel qendror.

IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHMPU-së

1. ISHMPU-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.
2. Stema e ISHMPU-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”.
3. Vula e ISHMPU-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e ISHMPU-së në nivel qendror përmban edhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, ndërsa vulat e degëve rajonale përmbajnë shënimin identifikues: “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale e Qarkut (emri përkatës i qarkut)”.
4. Vula e ISHMPU-së dhe vulat e degëve rajonale prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Mjedisit, që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për paraqitjen e propozimit të Kryeministrit për:
 - a) emërimin e kryeinspektorit të ISHMPU-së;
 - b) miratimin e strukturës e të organikës së ISHMPU-së, sipas ligjit.
2. Kryeinspektori i ISHMPU-së, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Mjedisit dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve, të miratuara nga Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMPU.
3. Nëpunësit, që kryejnë funksionet e inspektimit, që janë aktualisht të emëruar pranë Ministrisë së Mjedisit, përfshirë institucionet e saj të varësisë apo drejtoritë e saj rajonale dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, transferohen në detyra të reja pranë ISHMPU-së, brenda numrit dhe pozicioneve të organikës së miratuar sipas urdhrit përkatës të Kryeministrit.
4. Nëpunësit ekzistues, që nuk mund të transferohen në ISHMPU, mbeten në institucionet përkatëse, të cilat riorganizohen brenda një periudhe 2-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
5. Në çdo rast, kryerja e procedurave sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij kreu, kryhet duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
6. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ministri i Mjedisit përcakton edhe rishpërndarjen e mjediseve e të mjeteve të punës, si dhe merr masat e duhura për financimin me fonde buxhetore të ISHMPU-së për vitin buxhetor 2014.
7. Çdo dispozitë apo akt nënligjor, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.
8. Vendimi nr. 223, datë 13.3.2013 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit”, shfuqizohet.

VI. Ngarkohet ministri i Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet në datën 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 47, datë 29.1.2014

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT E TË AGJENCIVE RAJONALE TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Objekti dhe përkufizime

1. Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, për ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve, si dhe për marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

2. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

- a) “AKM”, Agjencia e Kombëtare e Mjedisit;
- b) “TMD” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- c) “PMM”, praktikat më të mira mjedisore;
- ç) “Ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”” është ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- d) “Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”” është ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- dh) “Ligji “Për lejet e mjedisit”” është ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar;
- e) “Ligji “Për nëpunësin civil”” është ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.
- ë) “Kodi i Punës” është ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- f) “Kodi Civil” është ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- g) “Njësitë e qeverisjes vendore” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e njësisve të qeverisjes vendore”.

II. Organizimi i AKM-së

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim “AKM”) është institucion qendror publik në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit.

2. AKM-ja ushtron funksionet e ngarkuara nga ligjet “Për mbrojtjen e mjedisit”, “Për lejet e mjedisit”, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ky vendim dhe çdo akt ligjor dhe nënligjor, i posaçëm.

3. AKM-ja ka pavarësi në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e funksioneve të saj.

4. AKM-ja ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës së saj qendrore dhe agjencive rajonale të mjedisit (në vijim “ARM”).

5. Punonjësit dhe nëpunësit e AKM-së u nënshtrohen legjislacionit për nëpunësin civil dhe legjislacionit të punës referuar nenit 61 të ligjit nr. 10431, datë 14.7.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

III. STRUKTURAT E AKM-së

III/I. DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM-së

1. Titullari i AKM-së është drejtori i përgjithshëm.

2. Drejtori i përgjithshëm emërohet referuar ligjit nr. 10431, datë 14.7.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

3. Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrit emërimin dhe lirimin e drejtorëve të ARM-ve, mbështetur në urdhrin e Kryeministrit për strukturën e drejtorive rajonale.

4. Drejtori i përgjithshëm i propozon ministrit emërimin dhe lirimin e zëvendës drejtorit, funksion i cili do të ushtrohet nga një prej drejtorëve të AKM-së.

5. Zëvendës drejtori kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë vendim dhe ushtron të gjitha kompetencat e deleguara nga drejtori i përgjithshëm.

6. Drejtori i përgjithshëm i AKM-së:

a) përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së kësaj agjencie;

b) ka të drejtën dhe autoritetin të lidhë marrëveshje mbështetur në legjislacionin shqiptar me qëllim përmbushjen e objektivit të punës së kësaj agjencie;

c) i propozon ministrit emërimin dhe lirimin nga detyra të punonjësit të kësaj agjencie, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

ç) administron buxhetin e miratuar të agjencisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) përgatit projekt buxhetin vjetor të kësaj agjencie për vitin pasardhës dhe ia propozon ministrit;

dh) bashkërendon punën për aktivitetet e kësaj agjencie me institucionet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe me ente të tjera publike.

III/II. ZËVENDËSDREJTORI

1. Zëvendës drejtor do të jetë një prej drejtorëve të AKM-së, i cili emërohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

2. Detyrat dhe kompetencat e zëvendës drejtorit janë ato të deleguara me urdhër të brendshëm nga drejtori i përgjithshëm.

IV. SELIA, STEMA DHE VULA ZYRTARE E AKM-së

1. AKM-ja ka zyrën qendrore të saj në Tiranë dhe degët rajonale në qarqe (ARM).

2. AKM-ja ka stemën dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKM-së prodhohet në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.

3. Në vulën zyrtare të AKM-së shkruhet me shkronja kapitale “AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT”, ndërsa në vulën zyrtare të ARM-ve shkruhet me shkronja kapitale: “AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT, AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT (emri i rajonit përkatës)”.

4. ARM-të kanë zyrat e tyre në qarqet përkatëse pranë prefekturave dhe/ose bashkive përkatëse.

5. Selitë e zyrave të ARM-ve përcaktohen me urdhër të ministrit.

V. FUNKSIONET E AKM-së DHE TË ARM-ve

1. AKM-ja, përmes zyrës qendrore dhe ARM-ve, ushtron funksionet e mëposhtme:

a) kryen funksione rregullatore për lejet e mjedisit në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës;

b) monitoron dhe vlerëson gjendjen e mjedisit dhe përgatit Programin Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit;

c) përgatit dhe publikon raportin për gjendjen e mjedisit dhe botime të tjera që kanë lidhje me mjedisin;

ç) kryen kërkime shkencore që lidhen me mjedisin ose kërkime të tjera për zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionin;

d) përcakton TDM-në dhe PMM-në;

dh) ngre dhe mirëmban sistemin e informacionit për dokumentet e referencës për TDM-në, të miratuara nga ministri;



- e) bashkëpunon me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe me organizata të tjera ndërkombëtare mjedisore dhe plotëson detyrimet raportuese përkatëse;
 - ë) krijon dhe menaxhon sistemin e informacionit mjedisor;
 - f) krijon dhe menaxhon Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
 - g) siguron informacion mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore;
 - gj) siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore;
 - h) menaxhon sistemin e të dhënave për pyjet;
 - i) përgatit dhe mbikëqyr Inventarin Kombëtar të Pyjeve;
 - j) zhvillon planet e menaxhimit të pyjeve;
 - k) monitoron pyjet në drejtim të zbatimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - l) siguron zhvillimin dhe transferimin e teknologjive në lidhje me pyjet;
 - ll) i paraqet ministrit projektpropozime për mbështetje teknike të financuara nga buxheti i shtetit dhe donatorë ndërkombëtarë;
 - m) shqyrton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - n) këshillohet dhe bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe inspektoratet e tjera në zbatim të legjislacionit mjedisor, përfshirë situatat e incidenteve, aksidenteve dhe emergjencave në mjedis;
 - nj) përgatit formatin standard të kërkesës, informacionin që duhet të përmbajë kërkesa dhe formatin e lejes së mjedisit të tipave “A” dhe “B” dhe ia propozon ministrit për miratim;
 - o) përcakton kushtet e lejes së tipave “A” dhe “B”;
 - p) përgatit raport administrativ vjetor për veprimtarinë e kryer;
 - q) funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.
2. Agjencitë rajonale të mjedisit, brenda kompetencave që iu njeh ligji, ushtrojnë funksionet e mëposhtme:
- a) japin lejen e mjedisit të tipit “C”, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10431, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
 - b) mbajnë dhe përditësojnë regjistrin me të dhëna për instalimet e kategorisë “C”, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre.
3. Për ushtrimin e funksioneve të saj, AKM-ja:
- a) duhet të informohet për politikën dhe objektivat e autoriteteve publike, funksionet e të cilave kanë ose mund të kenë ndikim në çështjet që mbulon agjencia;
 - b) duhet të ketë parasysh nevojën për mbrojtjen e mjedisit në nivel të lartë dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.
4. AKM-ja ushtron funksionet këshillimore me nismën e vet apo me kërkesë të ministrit, si më poshtë vijon:
- a) i rekomandon ministrit të bëjë propozime për hartimin e akteve të reja, për ndryshime ligjore apo për çështje të tjera që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
 - b) përgatit informacione për çështje të ndryshme të mjedisit për ministrin, organe të qeverisjes qendrore dhe vendore, sipas kërkesës së tyre;
 - c) organizon konferenca, seminare, trajnime në fushën e vet të veprimtarisë;
 - ç) përgatit për ministrin informacione vlerësimi për ndikimet që mund të vijnë nga propozimet për miratim apo ndryshime legjislative në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.
- VI. KONTRATAT DHE MARRËVESHJET**
- AKM-ja:**
- a) lidh marrëveshje dhe bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore mbështetur në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e njërive të qeverisjes vendore”, si dhe në legjislacionin mjedisor;

b) ka të drejtë të kontraktoshë konsulentë për përmbushjen e funksioneve të saj. Çdo pagesë për konsulentin e kontraktuar do të mbulohet nga burimet financiare përkatëse;

c) lidh dhe zbaton kontratat civile, të parashikuara nga Kodi Civil;

ç) përfshin në raportin administrativ vjetor informacion për marrëveshjet dhe kontratat e sipërpërmendura.

VII. BUXHETI

1. Buxheti i AKM-së financohet nga buxheti i shtetit.

2. AKM-ja siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. Tarifat e këtyre shërbimeve përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

3. AKM-ja administron të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe ato të siguruara nga shërbimet ndaj palëve të tjera, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. AKM-ja harton projektbuxhetin vjetor në bazë të projektprogramit vjetor të saj.

VIII. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Ministri, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të marrë masat për t'i paraqitur:

a) Këshillit të Ministrave propozimin për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të AKM-së;

b) Kryeministrit propozimin për strukturën dhe organigramën e AKM-së.

2. Drejtori i përgjithshëm i AKM-së i propozon ministrit kërkesat specifike për çdo pozicion në këtë agjenci.

3. Punonjësit që aktualisht janë emëruar në AMP dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të kësaj nënndarjeje, transferohen në pozicionet e reja të AKM-së, sipas urdhrimit të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organigramës.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Agjencia e Pyjeve dhe Mjedisit nuk ekziston më, pasi do të quhet Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe zyrat, ambientet e punës, pajisjet, dokumentacioni, fondet buxhetore dhe vlerat e tjera monetare të AMP-së do të jenë të AKM-së.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Mjedisit.

IX. SHFUQIZIME

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 20.12.1993 "Për krijimin e agjencive rajonale të mbrojtjes së mjedisit në prefektura", nr. 579, datë 23.8.2006 "Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve", dhe çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

X. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 48, datë 29.1.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 541, DATË 13.6.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LANDFILLIT "BAJKAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 541, datë 13.6.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3, 4 dhe 6 ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore, me një vlerë të përgjithshme prej 20 734 735 (njëzet milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Shuma e përgjithshme e shpronësimit prej 20 734 735 (njëzet milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga “Ilogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

...

6. Shpronësimi të fillojë në datën 29.1.2014.”.

b) Tabela bashkëlidhur vendimit, e cila përmendet në pikën 3 të tij, zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Këshilli i Qarkut të Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAREVE QE PREKEN NGA NDERTIMI I LANDFILLIT NE FSHATIN PALAVLI KOMUNA VERGO

Nr.	Pronari		Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. m2	Çmimi l/m2	Vlera	Shenime
	Emer	Mbiemer						
1	Kadri	Dauti	2864	663/1	399	645,6	257594,4	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Petrit	Dauti	2864	664/1	239	645,6	154298,4	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Eqerem	Dauti	2864	665/1	773	645,6	499048,8	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Rabie	Raça	2864	666	356	645,6	229833,6	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Sihat	Raça	2864	667	310	645,6	200136	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Idriz	Raça	2864	668	528	645,6	340876,8	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Nesip	Raça	2864	669	679	645,6	438362,4	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Bastri	Raça	2864	670/1	2076	645,6	1340265,6	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Vesel	Sinani	2864	671/1	843	645,6	544240,8	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Nazie	Sinani	2864	672/1	1009	645,6	651410,4	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Taip	Sinani	2864	673/1	958	645,6	618484,8	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Teki	Dauti	2864	676, 677	4038	645,6	2606932,8	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Sinan	Kuçi	2864	678/1	851	645,6	549405,6	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Ago	Kuçi	2864	679	1859	645,6	1200170,4	Derguar per likuidim sipas VKM nr. 541, dt. 13.6.2013
15	Nedin	Kuçi	2864	680/1	2322	645,6	1499083,2	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Shahin Haderi (Bashkepronare)		2864	681	7123	645,6	4598608,8	Derguar per likuidim sipas VKM nr. 541, dt. 13.6.2013
17	Arfi	Haderi	2864	683/1	3404	645,6	2197622,4	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Shpetim	Dauti	2864	725/1	22	645,6	14203,2	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Teno	Dauti	2864	726	2215	645,6	1430004	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Daut	Alinani	2864	727	2113	645,6	1364152,8	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA TOTALE					32.117		20.734.735	

VENDIM
Nr. 5, datë 28.1.2014

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.1.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Mirela Neli.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 91/1 prot., datë 23.1.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mirela Neli, deputete e zonës zgjedhore qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 35, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 2 mandate, dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Lezhës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Mimi Pjetër Kodheli, me numër rendor 2 (dy) Armando Ndue Prenga.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mimi Kodheli, deputete e zonës zgjedhore, qarku Lezhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 852, datë 26.12.2013, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mejreme Delishi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Mejreme Delishi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Lezhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1, datë 20.1.2014, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mirela Neli.

Rezultoni se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste në qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i përket kandidatës znj. Mirela Neli, e cila i përket gjinisë



më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të duhej të zbatonte përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, duke ia dhënë mandatin kandidatës së radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Lezhë, rezultoi se pas znj. Mirela Nelit nuk ka më kandidatë nga gjinia femërore, e cila është dhe gjinia më pak e përfaqësuar. Në këto kushte, KQZ-ja nuk mund të aplikojë rregullin e përjashtimit, pasi emrat e gjinisë më pak të përfaqësuar, pra të gjinisë femërore kanë shteruar.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i kalon kandidatit të radhës, i cili, sipas listës shumemërore për zonën zgjedhore, qarku Lezhë të Partisë Socialiste, është kandidati me numër rendor 3 (tre) z. Arben Ndue Ndoka.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, z. Arben Ndue Ndoka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kryetare: Lefterije Luzi (Lleshi)

Anëtarë: Hysen Osmanaj, Klement Zguri, Vera Shtjefni

VENDIM

Nr. 6, datë 28.1.2014

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.1.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetare

Hysen Osmanaj anëtar

Klement Zguri anëtar

Vera Shtjefni anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Durrësit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Silvana Maksuti.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a” dhe neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 202/1 prot., datë 23.1.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Silvana Maksuti, deputete e zonës zgjedhore, qarku Durrës.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 33, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Durrës, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zonën zgjedhore, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 1 mandat dhe kandidati fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Durrësit, është kandidati me numër rendor 1 (një) z. Lefter Koka.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 2, datë 20.1.2014, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Silvana Maksuti, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Lefter Koka, deputet i zonës zgjedhore, qarku Durrës.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Durrësit, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance, të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e LSI-së, në zonën zgjedhore, qarku Durrës, duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumëmemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumëmemërore për çdo zonë zgjedhore, në listën shumëmemërore të LSI-së, në qarkun Durrës, kandidatja e renditur e para nga gjinia më pak e përfaqësuar, është kandidatja me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) znj. Merita Gani Kuçi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, znj. Merita Gani Kuçi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kryetare: Lefterije Luzi (Lleshi)

Anëtarë: Hysen Osmanaj, Klement Zguri, Vera Shtjefni

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë